



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI I PROVËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

R A P O R T
PËR MUAJIN MARS 2011

I nderuar Zoti Ministër,

Mbështetur në nenin 9, gërma gj), të VKM nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative", po Ju paraqesim raportin e veprimtarisë së Shërbimit të Provës për muajin Mars 2011.

I. Statistika

Për periudhën 01-31 Mars 2011, volumi i punës së kryer nga Shërbimi i Provës ka qenë i madh, duke marrë parasysh faktin që numri i specialistëve të Zyrave Vendore të Shërbimit të Provës është i njëjti, ndërsa numri i të dënuarve me dënime alternative që këta specialistë mbikëqyrin, si dhe kërkesat nga gjykatat dhe prokuroritë për raporte vlerësimi janë në rritje të vazhdueshme. Disa nga statistikat dhe paraqitjet që pasqyrojnë punën që ka kryer e po kryen institucioni do të jepen me anë të të dhënave si më poshtë:

Për periudhën 01- 31 Mars 2011, statistikat rezultojnë si më poshtë:

1. Numri total i të dënuarve me dënime alternative të dhëna nga gjykatat.

Numri total i të dënuarve me dënime alternative që janë mbikëqyrur nga Shërbimi i Provës në të gjithë vendin, për periudhën **01.06.2009 - 31.03.2011**, është **3066** të dënuar.

Nga 01.06.2009 deri më datë 31.03.2011, kanë përfunduar periudhën e provës nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës **328** të dënuar, pra ka përfunduar me sukses procesi i mbikëqyrjes për ta.

Kështu numri total i të dënuarve që ndodhen aktualisht nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës (duke zbritur numrin e atyre që kanë përfunduar dënimin alternativ) është **2738** të dënuar.

I ndarë sipas Zyrave Vendore (duke llogaritur dhe të dënuarit që kanë përfunduar dënimin alternativ):

- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Tiranë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **1119** të dënuar me dënime alternative.

- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Durrës mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **259** të dënuar me dënime alternative.
 - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Fier mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **433** të dënuar me dënime alternative.
 - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Shkodër mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **391** të dënuar me dënime alternative.
 - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Lezhë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **170** të dënuar me dënime alternative.
 - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Elbasan mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **145** të dënuar me dënime alternative.
 - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Korçë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **156** të dënuar me dënime alternative.
 - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Gjirokastrë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **65** të dënuar me dënime alternative.
2. *Numri mesatar i të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga një punonjës i Shërbimit të Provës në nivel vendi dhe zyre vendore.*

Sa më sipër duke ju referuar numrit total të të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga Shërbimi i Provës prej **2738** të dënuarish, numri mesatar i të dënuarve që mbikëqyren nga një punonjës në nivel vendi aktualisht është **91**. E shprehur kjo për çdo zyrë vendore është si më poshtë:

- Zyra Vendore Tiranë ka nën mbikëqyrje **112** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Durrës ka nën mbikëqyrje **86** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Fier ka nën mbikëqyrje **72** të dënuar për çdo punonjës.

- Zyra Vendore Shkodër ka nën mbikëqyrje **130** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Lezhë ka nën mbikëqyrje **57** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Elbasan ka nën mbikëqyrje **73** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Korçë ka nën mbikëqyrje **78** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Gjirokastrë ka nën mbikëqyrje **65** të dënuar për çdo punonjës.

Duke ju referuar statistikave, gjatë muajit Mars 2011 kanë përfunduar periudhën e mbikëqyrjes 36 të dënuar. Shtesa për periudhën 01-31 Mars 2011, prej 196 të dënuarish nën mbikëqyrje, rrit dhe ngarkesën e punës për specialistët.

3. Numri i të dënuarve për secilin lloj dënimi alternativ.

Statistikat për periudhën **01.06.2009 - 31.03.2011**, për secilin lloj dënimi alternativ, për të dënuarit e mbikëqyrur nga Shërbimi i Provës, janë si më poshtë:

- **2415** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59 i KP *“pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”*, shifër kjo e barabartë me **78.77 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- **63** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59/a i KP *“qëndrim në shtëpi”*, shifër kjo e barabartë me **2.05 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- **325** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 64 i KP *“Lirim me kusht”*, shifër kjo e barabartë me **10.6 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- **263** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 63 i KP *“Pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik”*, shifër kjo e barabartë me **8.58 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.

- asnjë person nuk është dënuar nga gjykata duke aplikuar nenin 58 të KP "gjysëm-liria".

Këto të dhëna pasqyrohen më poshtë, në Tabelën 2.

Tabela 2: Numri i të dënuarëve sipas llojeve të dënimeve alternative të dhëna nga Gjykata për periudhën 01.06.2009 – 31.03.2011.

Nr	LLOJI I DËNIMEVE ALTERNATIVE	Nr. TOTAL	TOTALI në %
1	Pezullimi ... neni 59 i KP	2415	78.77%
2	Qëndrimi në shtëpi neni 59/a i KP	63	2.05%
3	Lirimi me kusht neni 64 i KP	325	10.6%
4	Punë në interes publik neni 63 i KP	263	8.58%
5	Gjysmëliria neni 58 i KP	0	0%
TOTALI		3066	100%

Për periudhën 01.06.2009 – 31.03.2011 numri i të dënuarve me "punë në interes publik" është **263**, ndërsa pas përfundimit të këtij dënimi për 193 të dënuar, Shërbimi i Provës ka nën mbikëqyrje **70** të dënuar.

4. Raportet e Vlerësimit me kërkesë të gjykatës dhe prokurorisë.

Konkretisht për periudhën **01-31 Mars 2011:**

- ❖ Janë kërkuar nga gjykatat **53** raporte vlerësimi për persona të pandehur dhe të dënuar,
- ❖ Janë kërkuar nga prokuroritë **44** raporte vlerësimi për persona nën hetim dhe të pandehur,
- ❖ Kanë ardhur **196** urdhëra ekzekutimi nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, nga të cilët **44** urdhëra ekzekutimi janë për dënime alternative të dhëna për të mitur, për të cilët gjykata ka dhënë dënime alternative dhe kanë filluar procedurat ligjore të përcaktuara për procesin e mbikëqyrjes për ta.
- ❖ Ka përfunduar mbikëqyrja për **36** të dënuar me dënime alternative.

Ndërsa në total volumi i punës së Shërbimit të Provës për periudhën 01.06.2009 - 31.03.2011 jepet si më poshtë:

- ❖ janë kërkuar nga gjykata **1263** raporte vlerësimi për persona të pandehur dhe të dënuar,
- ❖ janë kërkuar nga prokuroritë **641** raporte vlerësimi për persona nën hetim dhe të pandehur,
- ❖ Kanë ardhur **3066** urdhëra ekzekutimi nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, nga të cilët **485** urdhëra ekzekutimi janë për dënime alternative të dhëna për të mitur, për të cilët gjykata ka dhënë dënime alternative dhe kanë filluar procedurat ligjore të përcaktuara për procesin e mbikëqyrjes për ta.
- ❖ Ka përfunduar procesi i mbikëqyrjes për **328** të dënuar.

II. Bashkëpunimi me partnerët

- *me OJF-të dhe partnerët.*

- Për sa i përket bashkëpunimit me OJF-të, përveç Memorandumeve të Bashkëpunimit që kemi me 6 OJF, për të cilat ju kemi bërë me dije në raportet e mëparshme, në muajin Mars 2011 kemi nënshkruar edhe një memorandum me OJF-në, Shoqatën "Përthyerje", e cila ka si objekt ndihmën e personave të dënuar me dënime alternative, familjeve dhe fëmijëve të tyre, nëpërmjet ofrimit të programit këshillimor për menaxhimin e zemërimit, i cili konsiston në seanca terapeutike për menaxhimin e sjelljeve antisociale dhe të dhunës, si dhe duke nxitur mundësitë konkrete për rehabilitim dhe integrim me anë të angazhimit të personave të dënuar në programe e trajnime profesionale, edukimi individual apo në grup, duke pasur si objektiv ri-integrimin e tyre në shoqëri.
- Në lidhje me Projektin e Binjakëzimit me Shërbimin e Provës Britanik, (Albanian Twinning Project - Probation Service, AL 09 IB JH 01 "Support to the Establishment of the Probation Service and Alternative Measures to Detention", në datën 25 Mars 2011, u zhvillua në ambjentet e Ministrisë së Drejtësisë, ceremonia e hapjes së këtij projekti. Në këtë ceremoni merrnin pjesë Ministri i Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë,

Z. Bujar Nishani, Ministri i Drejtësisë së Mbretërisë së Bashkuar, Z. Lord Tom McNally, Ambasadori i Delegacionit të Bashkimit European, Z. Ettore Sequi, zyrtarë të lartë të të dy ministrive, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, Z. Arben Sefgjini, si dhe pjesëmarrës nga trupi diplomatik, gjykatat, prokuroritë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Policia e Shtetit, nga OJF-të e ndryshme, etj. Pas ceremonisë së hapjes, u bë prezantimi i komponentëve të projektit, si dhe u theksua bashkëpunimi ndërmjet palëve përfaqësuese të tij, për çështjet që kanë të bëjnë me këtë projekt. Më pas, u zhvillua një tavolinë e rrubullakët, me temë: "Shërbimi i Provës nga një perspektivë ndërkombëtare", ku ishin të ftuar pjesëmarrës me të cilët Shërbimi i Provës bashkëpunon në kryerjen e misionit të tij, si gjyqtarë prokurorë, përfaqësues nga Policia e Shtetit, burgjet OJF të ndryshme, etj. Në prezantimin e tij, Z. Alan John MacDonald, këshilltar resident i projektit të binjakëzimit, vlerësoi arritjet e deritanishme të bëra nga Shërbimi i Provës Shqiptar për këtë periudhë, që nga krijimi i tij deri në momentin aktual në të cilin ndodhemi. Gjithashtu u referuan temat "Shërbimi i Provës në Angli"- Përvoja e Kryenspektorit të Shërbimit të Provës për Anglinë dhe Uellsin, Z. Andrew Bridges; "Zhvillimet e Shërbimit të Provës në Europë dhe Organizata Europiane e Shërbimit të Provës - Përvoja e Shefit të Departamentit të Projekteve Ndërkombëtare në Ministrinë e Drejtësisë, Z. Kevin Barry. Në përfundim, përfaqësuesit britanik ju përgjigjën pyetjeve të pjesëmarrësve të ftuar, në lidhje me çështje të funksionimit të Shërbimit të Provës.

Në lidhje me ecurinë e Projektit, gjatë muajit Mars 2011 janë zhvilluar takime të këshilltarit resident të projektit, Z. Alan John MacDonald, në disa Zyra Vendore të Shërbimit të Provës, në Fier, Lezhë, Shkodër dhe Durrës, në lidhje me komponentët e projektit, si dhe për çështjet që kanë të bëjnë me të, në të cilat është diskutuar për mbarëvajtjen e punës dhe për problematikën e saj, si dhe janë zhvilluar takime dhe diskutime me specialistët e këtyre Zyrave Vendore. Gjithashtu janë realizuar takime me drejtues të gjykatave, prokurorëve dhe OJF-ve që operojnë në këto rrethe. Gjatë këtyre takimeve janë shprehur mendimet e tyre mbi ecurinë e deritanishme të bashkëpunimit mes institucioneve tona dhe është vlerësuar puna e Shërbimit të Provës.

Takimet në zyrat e tjera vendore do zhvillohen në muajin Prill 2011.

Në datat 28 Mars u zhvillua trajnimi i parë, në kuadër të Projektit të Binjakëzimit të sipërcituar, me 8 punonjës të Shërbimit të Provës, nga Drejtoria e Përgjithshme dhe Zyrat Vendore. Ky trajnim, u realizua në ambjentet e Drejtorisë së Përgjithshme. Gjatë 5 ditëve të trajnimit, temat u referuan nga dy lektorë britanikë me eksperiencë të pasur për Shërbimin e Provës, si dhe u diskutua me një gjyqtar dhe një prokuror të Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Në datën 30 Mars 2011, në ambjentet e Hotel "Sheraton", u zhvillua seanca e raportimit të Ministrisë së Drejtësisë, në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të Komisionit Europian, ku në një pjesë të këtyre rekomandimeve bëhej fjalë edhe mbi veprimtarinë e Shërbimit të Provës. Nga pjesëmarrësit e organizatave të huaja, si OSBE dhe përfaqësuesit të BE, por edhe atyre vendase, u vlerësua ngritja e institucionit të Shërbimit të Provës dhe u theksua puna e mirë dhe ecja në rrugën e duhur, që ka bërë dhe po bën institucioni i Shërbimit të Provës për sa i përket zbatimit dhe mbikëqyrjes së dënimeve alternative.

- me organet e pushtetit qëndror dhe pushtetin vendor

Për sa i përket bashkëpunimit me pushtetin vendor, përveç 78 memorandumeve të bashkëpunimit midis Shërbimit të Provës dhe organeve të qeverisjes vendore, për të cilat ju kemi bërë me dije në raportet tona të mëparëshme, për muajin Mars 2011, kemi nënshkruar edhe 1 memorandum bashkëpunimi me Komunën Ballaban të qarkut Gjirokastrë.

Pra në total janë nënshkruar 79 memorandume bashkëpunimi me organet e qeverisjes vendore dhe konkretisht me 6 Këshilla Qarqesh, 27 Bashki (nga të cilat 5 Njësi Bashkiake) dhe 46 Komuna. Ndërkohë që vazhdon puna dhe korespondenca për nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit edhe me bashkitë dhe komunat e tjera.

Në kuadër të rritjes së transparencës së aktivitetit të Shërbimit të Provës dhe implementimit të alternativave të dënimit me burgim, në muajin Mars 2011 është bërë shpërndarja e Buletinit nr. 1 të Shërbimit të Provës, pranë të gjitha IEVP-ve, pranë njësive të qeverisjes vendore, qarqeve, bashkive

dhe komunave me të cilat kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, si dhe Drejtorive të Policisë së Shtetit në qarqe dhe komisariateve.

Gjithashtu në muajin Mars 2011, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, përgatiti dhe printoi Vjetarin e parë Statistikor të Shërbimit të Provës për vitet 2009, 2010 dhe periudhën 2009-2010, me të dhëna statistikore për institucionin e Shërbimit të Provës. Një kopje të këtij vjetari e kemi dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë me shkresën përcjellëse nr. 511 prot., datë 16.03.2011.

III.-Problematika e punës.

- *Zyrat e reja Vendore dhe ngarkesa.*

Gjatë muajit Mars 2010 kemi vazhduar me intensitet menaxhimin e punëve për sistemimin në ambiente normale pune, të zyrave vendore të Shërbimit të Provës, si dhe të sigurimit të infrastrukturës për to, me qëllim mirëfunksionimin e aktivitetit të këtyre zyrave vendore.

Sikurse ju kemi bërë me dije dhe në kërkesë-propozimin tonë me nr. 88 Prot., datë 13.01.2011, për ndryshimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të Provës, si dhe në Raportin Vjetor mbi aktivitetin e Shërbimit të Provës, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2010, dërguar me tonën nr. 378, datë 28.02.2011, problemi kryesor del hapja e zyrave të reja vendore me vendodhje në të gjitha rrethet gjyqësore ku nuk janë ngritur ende, si dhe ndryshimi i strukturës dhe shtimi i organikës së Shërbimit të Provës, me qëllim administrimin dhe ushtrimin e funksioneve në mënyrën e kërkuar nga ligji dhe arritjen e standardeve të parashikuara në Strategjinë Sektoriale të Drejtësisë dhe SKZHI-së, për Shërbimin e Provës, ku një nga indikatorët është dhe raporti i numrit të dënuarve që mbikëqyren mesatarisht për një specialist të Shërbimit të Provës, përkatësisht 35 të dënuar /specialist.

Mjafton të përmendim se deri tani janë në mbikëqyrje nga institucioni ynë 2738 të dënuar, ose mesatarisht **91 të dënuar për çdo specialist**, numër i cili vazhdon të rritet, dhe që është shumë më i lartë se standartet e vendeve europiane, pa shtuar këtu faktin se punonjësit tanë deri më tani kanë hartuar mesatarisht edhe **63 raporte vlerësimi për specialist**, sipas kërkesave të gjykatave dhe prokurorive, gjë që e bën të papërbalueshme ngarkesën e punës.

Duke shpresuar se kemi dhënë një analizë që pasqyron me objektivitet punën e kryer, si dhe një paraqitje të problematikës themelore nga Shërbimi i Provës, Ju sigurojmë se zbatimi i të gjithë detyrave funksionale, rritja e nivelit dhe e profesionalizmit do të jenë prioritete të punës sonë edhe në të ardhmen.

Me respekt,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ARBEN SEFGJINI

